



Pranimi / Protokoll Pranimje / Protokol Acceptance / Protocol	18.01.2022	Viti viti Year	2022
Organ / Organizata Org. / Org.	Dr. Prati Dr. Prati	Shërbimi Shërbimi	Sasia Sasia
SKPM/SHCK	221/2022	Appendix	Quantity 114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1007/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1007/2021 të datës 06.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me në kundër Vendimit me Nr.12/2021 të datës 08.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1007/2021 e datës 06.12.2021 e parashtruar nga ankuesi nga

II.Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.12/2021 i datës 08.11.2021 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi Zyrtar i Lartë i Rimbursimeve në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 5817 të regjistruar me numër A.nr.1007/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.12/2021 të datës 08.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.12.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këshilli më datë 20.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa e parashtruar nga ankuesi është e prapueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 5817 të regjistruar me numër A.nr.1007/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.12/2021 të datës 08.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës; Emailin e datës 18.10.2021, 20.10.2021 nga për ankuesin; Emailat e datës 08.10.2021 nga ankuesi për Emailat e datës 08.10.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 28.10.2021, 29.10.2021 nga ankuesi për Kërkesën e ankuesit të datës 29.10.2021; Vërejtjen e datës 09.10.2020; Vërejtjen e datës 11.06.2021; Lista e lëndëve të deleguara të TVSH prej 01.01-30.09.2021; Shkresa me titull Mesatarja e vonesave sipas kategorive për datë 01.01-30.09.2021; Rregulloren e Brendshme të ATK Nr.01/2020 mbi Procedurat e Rimbursimeve; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 20.12.2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 12.02.2020; Akt Emërimi i datës 08.11.2019; Shkresë përcjellëse për KD e datës 12.10.2021; Emailin e datës 11.01.2021 nga për Shkresën për Inicimin e procedurës disiplinore e datës 11.10.2021; Emailin e datës 12.10.2021 nga për Emailin e datës 11.10.2021 nga Emailin e datës 11.10.2021 nga për Emailin e datës 08.10.2021 nga Emailin e datës 09.10.2021 nga për Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 27.10.2021 dhe 05.11.2021; Emailin e datës 02.11.2021, 15.10.2021 nga për Listën e ditëve të pushimeve për ankuesin; Emailin e datës 18.10.2021 nga për Emailin e datës 18.10.2021 nga për Raportin mbi rastin e trajtuar nr.09/21-DSP i datës 22.06.2021; Emailin e datës 22.06.2021 nga për Emailin e datës 14.06.2021 nga për Emailin e datës 14.06.2021 nga për Emailin e datës 11.06.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 16.06.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 16.06.2021 nga ankuesi për Vendimin e datës 07.07.2021 për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor të ATK-së; Vendimin e datës 13.10.2021 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor të ATK-së; Emailin e datës 12.10.2021 nga për Emailin e datës 12.10.2021 nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa A.nr.1007/2021 e datës 06.12.2021, *është e pabazuar, sepse:*

Në bazë të shkesave të lëndës, gjegjësisht Aktit të Emërimit të datës 12.02.2020, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Rimbursimeve në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit, me datë 09.10.2020 dhe 11.06.2021 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", ndërsa me datë 11.10.2021 ndaj ankuesit është iniciuar procedurë disiplinore me arsyetimin se ankuesi vonohet në shqyrtimin e lëndëve të rimbursimit përtej çdo afati ligjor, nuk respekton hierarkinë dhe se ndaj të njëjtit janë shqiptuar dy vërejtje me shkrim për të njëjtën çështje.

Komisioni Disiplinor në ATK, pas mbajtjes së seancave disiplinore, më datë 08.11.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.12/2021 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim 30% të pagës për një periudhë tre (3) mujore".

Kundër Vendimit Nr.12/2021 të datës 08.11.2021 të Komisionit Disiplinor të ATK-së, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se nuk i janë ofruar fakte mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa

disiplinore, sepse sipas ankuesit i njëjti ka respektuar të gjitha afatet ligjore në përmbushjen e detyrave të punës sipas Rregullores Nr.01/2020 mbi Procedurat e Rimbursimeve. Me tutje ankuesi pretendon se Komisioni Disiplinor nuk ka mundur të marr për bazë vërejtjet e shqiptuar me herët, me rastin e përcaktimit të masës disiplinore ndaj tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me shqiptimin e masës disiplinore dhe rrjedhimisht duke ju referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi gjatës seancës së Komisionit Disiplinor të mbajtur më datë 27.10.2021 ka kërkuar nga anëtarët e Komisionit Disiplinor që t'i japin kohë për mbledhjen e fakteve dhe provave të cilat dëshmojnë të kundërtën e asaj për të cilën udhëheqësi i drejtpërdrejt ka iniciuar procedurë disiplinore, dhe sipas kësaj kërkesë ankuesit i është dhënë afat deri më datë 29.10.2021, në fund të orarit të punës që të përcjell çfarëdo dokumenti që vërteton pafajësinë e tij.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti ka respektuar të gjitha afatet ligjore në përmbushjen e detyrave të punës sipas Rregullores Nr.01/2020 mbi Procedurat e Rimbursimeve Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke iu referuar shkresave të lëndës të ofruar nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka gjetur se lëndët e kategorisë A respektivisht lënda *Anikos* nuk është përgatitur sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr.01/2020 mbi Procedurat e Rimbursimeve, përkatësisht nenin 7/A, ku përcaktohet se: *Kohëzgjatja e shqyrtimit dhe trajtimit të këtyre rasteve sipas kategorisë A, duhet të jetë jo më shumë se shtatë (7) ditë.* Pra, në rastin në fjalë, lënda nuk është shqyrtuar brenda afateve ligjore sepse e njëjta nuk është shqyrtuar deri më datë 11.10.2021 këtë e dëshmon e-maili zyrtar i datës 08.10.2021, si dhe e-maili i datës 12.10.2021 dërguar nga _____ për _____ dhe e-maili i datës 11.10.2021 dërguar nga _____ kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji, po ashtu, duke ju referuar procesverbalit të datës 27.10.2021 të seancës së Komisionit Disiplinor, lidhur me pyetjen e kryesuesit të komisionit disiplinor *si i shpjegoni ofendimet që ja ke bërë përmes emailit udhëheqësit tuaj, po jo vetëm atij, ankuesi është përgjigjur... lidhur me etiketimet e ndjej vetëm përgjegjës.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Disiplinor me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore nuk ka mundur të marr për bazë vërejtjet e shqiptuar me herët nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 ku përcaktohet se: *1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.3 ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht nenin 13 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 ku përcaktohet se: Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka vepruar drejt me rastin e verifikimit të dosjes së ankuesit në kuptim të ekzistimit të masave disiplinore, sepse bazuar në provat e administruara, shihet se në dosjen e ankuesit figurojnë dy masa disiplinore "Vërejtje", të shqiptuara më datë 09.10.2020, dhe me datë 10.06.2021, për të cilët nuk ka dëshmi se ankuesi ka parashtruar ankesë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar, sepse Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 13 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.*



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se Zyrtari publik duhet t'i ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës, dhe ka detyrim të veprorë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit, siç parashihet me nenin 25 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht ankuesi duke mos respektuar afatet e caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda, dhe shkeljet e përsëritura të rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil, ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 dhe 3.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, Kolegji konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr.12/2021 të datës 08.11.2021, në mënyrë të drejtë, dhe të plotë ka konstatuar gjendjen faktike duke vepruar kështu në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.*

Po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 11, 12, dhe nenin 13 paragrafi 3, 4 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk qëndron dhe rrjedhimisht pretendimi është i pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1007/2021

Avdyl BEKTESHI

Bekteshi
Procesmbajtës

Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në ATK; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

